

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit Y. Xh nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.3940/2015, të datës 03.10.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Beqë Shala, të akuzuarit, me datë 17.08.2017, morri dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Y. Xh nga i ati E, e ëma B, e vajzërisë B. i lindur më datë në Prizren, ku edhe jeton rr. pn, i pamartuar, student, i gjendjes se dobet ekonomike, shkollen e mesme te kryer, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves.

Ë S H T Ë F A J T O R


Sepse me date 16.12.2015, rreth ores 16,45 min, ne rrugen nga drejtimi i autobusve, ne drejtim te qendres se qytetit, perball libraris se quajtur me emrin “Baf” ne Prizren, duke mos ju permbajtur dispozitave te komunikacionit ne rruge, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jeten e njerezve, vepron ne kundersizim me nenin 54 dhe nenit 150 te LSKRR, duke mos i pershtatur shpejtesin kushteve te rruges ne komunikacion, dhe duke mos ju dhene perparesi kalimi kembesorit, ne ate menyre qe duke e drejtuar automjetin e markes “Opel-Kadet” me targa te regj. kurr arrin ne vendin kritik, nga pakujdesia me pjesen e perparme te automjetit te tije, e godet kembesorin – te demtuarin M. K i cili ishte duke trupuar rrugen nga ana e djathte ne anen e majte, me ç’rast si pasoje i demtuari peson lendime te lehta trupore dhe ate lendime keto te pershkruara si ne ekspertizen mjeko ligjore te dt.03.04.2016,

- kësodore kryen veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 43, par.1 pika 1.3, 46, 73, 74, 75, e 76 te KPK-se, si dhe nenit 365 te KP-se, te akuzuarit i shqipton:

D E N I M M E G J O B E

Ne lartesi prej 150 (njqindpesedhjete) Euro te cilen shume te denimit i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejti do te



zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, rrespektivisht 7 dite burgim.

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, ndërkaq ne emer te ekspertizes mjeko ligjore shumen prej 20,00 Euro, ne emer te ekspertizes te komunikacionit rrugor shumen prej 40,88 Euro, ndersa në emër të paushallit gjygjësor shumën prej 20 Euro, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I demtuari M. Z. K. nga Prizreni rr. nr. per realizimin e kerkeses pasuroro juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr. 3940/2015 te dt.03.10.2016, kunder te akuzuarit Y. Xh nga Prizreni, per shkak te vepres penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesise per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajesise eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhe ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana i te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, me te demtuarin e ka gjetur gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, eshte i gjendjes se dobet ekonomike, e poashtu ne kuptim te dispozitave te nenit 74, 75 e 76 gjykata morri per baze edhe faktin se i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën dhe se ai bashkepunim ka qene vullnetar qe nga hetimi deri te ndjekja penale, ka shprehur keqardhje per shkak te vepres se kryer penale, ka pasur sjellje korekte para gjykates, student, i pa pune, i gjendjes se dobet ekonomike, me te demtuarit e ka gjetur gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, gjer me tani i pa gjykuar, çka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe sepse konsideron se me me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 2118/2016 të datës 17.08.2017

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi



UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.